



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 147/3 Prot.

Tiranë, më 31.01.2025

V E N D I M

Nr. 5, datë 31.01.2025

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të nenit 147/d, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

V E N D O S A:

1. Miratimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2025, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Njësia e Inspektorëve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



Lidhja nr. 1 - Plani i inspektimeve për vitin 2025

Nr.	Lloji i inspektimit	Objekti i inspektimit	Periudha e realizimit të inspektimit	Organi i inspektuar	Afati i dorëzimit të raportit të inspektimit
1.	Tematik	Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024.	01.04.2025 – 31.12.2025	Gjykata e Lartë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	31.12.2025
2.	Tematik	Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024.	01.04.2025 – 31.12.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	31.12.2025
3.	Tematik	Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale për periudhën 01.01.2024 -31.12.2024.	01.04.2025-30.10.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	30.10.2025
4	Tematik	Mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore me palë kundërshtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024.	15.04.2025- 15.11.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë	15.11.2025

5.	Tematik	Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024.	01.04.2025 – 30.09.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër	30.09.2025
6	Tematik	Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendimmarrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024.	01.03.2025 -31.10.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë	31.10.2025
7	Tematik	Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.05.2024 – 31.07.2024.	10.02.2025 – 31.03.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan Gjykata e Shkallës së Parë te Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë	31.03.2025
8	Institucional	Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari deri në përfundimin e trajtimit të tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024.	15.04.2025 – 15.09.2025	Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër	15.09.2025